




Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce



Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 20/07/2018 miratoi këtë :

V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 20.06.2018

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit


Predrag Grbic





Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Strpce



PROCESVERBAL

Nga seanca e gjashtë të rregullt e KK-ës të mbajtur më 20.06.2018, me fillim në ora 10:00

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së së Shtërpçës
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i kornizës afatmesme buxhetore për vitin 2019-2021
4. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm
5. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës

Predrag Grbic: Të respektuari zëvendësit e kryetarit, këshilltar, drejtoret e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE dhe të gjithë të tjerë të pranishëm, mirëdita dhe mirë se vini në seancën e gjashtë të rregullt të K.K. Shtërpçë. Në seancën e sotme janë të pranishëm të gjithë 15 këshilltarë që do të thotë se kemi kuorumin dhe mund të fillojmë me punë. A dëshiron ndokush të marrë fjalën? Pasi askush nuk lajmërohet për fjalë, vërë në votim këtë pikë.
Konstatohet se me njëzë kemi aprovua rendin e ditës

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar e KK Shtërpçë

Predrag Grbic: A ka dikush vërejtje në procesverbalin? Pasi nuk ka, vë në votim këtë pikë.
Konstatohet se me njëzë kemi aprovua procesverbalin

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i kornizës afatmesme buxhetore për vitin 2019-2021

Danijel Vuksanović: Ne kemi marrë në mes të majit dokumentin e parë. Dmth. qarkoren buxhetore numër 1, e cilën ne ka dërguar Ministria e Financave. Ky është dokumenti i cili na jep kornizat kohore, të lidhura me planifikimin e buxhet për vitin 2019, si dhe parashikimet për vitet 2020-2021. Ne kemi afat që deri në 25 të këtij muaji t'ia përcjellim këtë dokument në Ministri e Financave. Letra e buxhetit gjithashtu na jep edhe udhëzime lidhur me planifikimin e

buxhetit dhe informacion mbi shumën e granteve të cilët e përbëjnë buxhetin e përgjithshëm të komunës së Shtërpçës. Komuna e Shtërpçës ka 4 lloje të granteve. E para është granti i përgjithshëm, granti i dytë për arsim, i treti është granti për shëndetësi primare, i katërti është për shëndetësi sekondare. Përveç këtyre granteve, ne gjithashtu kemi të ardhurat vetanake. Ky dokument e jep parashikimet tona, i cili është plani ynë për periudhën e ardhshme, ky dokument miratohet nga Kuvendi, nuk rishikohet. Ministria e Financave është e obliguar që të na përcjellë qarkore të dytë buxhetore në korrik, e cila në bazë të këtij dokumenti dhe analizës së saj do të jep limitin përfundimtarë në mes të kategorisë së shpenzimeve. Ne në bazë të planit të veprimit, të cilin e kemi miratuar në maj, në korrik do të fillojmë nga fshati Izance dhe Koshtanjev dhe më vonë në të gjitha fshatrat, me debate publike, ku me qytetarë do të diskutojmë për projektet kapitale, për të dëgjuar nga ata të cilët janë projekte kapitale me prioritetet në të gjitha fshatrat.

Rifat Rustemi: I përshëndes të gjithë të pranishmit. Kam një vërejtje, e lidhur me kryetarin e komunës. Kjo është tashmë seanca e 6 në të cilat kryetari i komunës nuk ka marrë pjesë, kjo për mua është poshtërimi i neve si përfaqësues i popullit dhe madje i vetë popullatës. Nëse ai nuk ishte i pranishëm disa herë, kjo nuk do të ishte problem, por kjo tashmë është shumë dhe duket se këto po bëjnë me ndonjë qëllim. Është pak e çuditshme që ai nuk ka qenë prezent asnjëherë deri më tani. Sa i përket kornizës buxhetore afatmesme, kam lexuar këtë dokument dhe kam disa vërejtje dhe sugjerime. Në fletën nr 5, prioritetet e komunës janë përcaktuar në 4 grupe, që është mirë. Granti për arsim mendoj se është i vogël, për shëndetësi ka shumë pak dhe për atë sekondare është pak. Për zhvillimin ekonomik dhe administrimin është e kënaqshme. Nuk do të ndodhë që spitali do të fillon të punojë në të ardhmen. Faqja. 10. Kur ka qenë regjistrimi i popullsisë, një numër i madh qytetarësh, si serbë dhe shqiptarë, nuk janë regjistruar dhe mendoj se ky është një problem i madh. Kjo nuk është e drejtë, sepse nëse qeveria ndan buxhetin për kokë banori, atëherë edhe komuna duhet të bëjë të njëjtën gjë. Ne jemi të dëmtuar më këtë, deri të regjistrimi i ardhshëm. Nuk do ta interpretohet sikur unë jam nacionalist, kjo është një gjendje e vërtetë që mund ta shohim, por kjo situatë duhet të jetë e balancuar për buxhetin midis serbëve dhe shqiptarëve. Faqja. 12. ku parashikohen projektet të ndryshme kapitale për infrastrukturën, shpresoj që kjo të vazhdojë. Në f. 11. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve, pritet që do të ketë një rritje për arsimin të mallra dhe shërbime për vitin 2019. Të gjitha shkollave janë marrë një mijë euro nga mallra dhe shërbime, mendoj se kjo është e paligjshme kanë marrë për transportin e nxënësve. Ata mjete duhet të kthehen që janë morë në vitin 2017, dhe të gjejnë një zgjidhje të përhershme.

Radojka Repinovic: Përgatitja e kornizës së buxhetore afatmesme është obligim ligjor i të gjitha institucioneve buxhetore komunale të kërkuara nga Ministria e Financave. Korniza afatmesme buxhetore për komunën tonë përmban të dhëna bazë zyrtare për prioritetet strategjike të zhvillimit të komunës tonë. Degat më të rëndësishme për zhvillim dhe prioritet i komunës janë: forcimi i ekonomisë, zhvillimi i turizmit, përmirësimi i shërbimeve publike për të gjithë qytetarët tanë, rritja e shërbimeve shëndetësore dhe rritja e cilësisë në arsim dhe kulturë. Prioritetet janë të përcaktuara shumë qartë, është hartuar një plan komunal dhe unë propozoj që të miratohet kjo kornizë afatmesme të buxhetit, për të krijuar mundësi për realizimin e këtyre prioritetëve.

Predrag Grbic: Së pari keni përmendë kryetarin e komunës. Unë e di se ai ka shumë obligime, megjithatë, mungesa e tij në Kuvend ka ndodhur në disa raste, nuk do të thotë se ai nuk ka bërë punën e tij në mënyrë të përgjegjshme dhe mos i përkushtuar veten për përmirësimin e kushteve

të jetesës së të gjithë qytetarëve në komunitetin tonë. Unë me përgjegjësi mund të them dhe gjithë drejtorët të pranishëm këtu, sepse takohemi rregullisht me kryetarin dhe diskutojmë për të gjitha problemet që kemi, për mos më ardhur në një situatë me ndodh një problem. Dhe kur bëhet fjalë për regjistrimin e popullsisë, kjo komunë kushton shumë, 500,000 € në çdo vit. Mos mendoni se ne kemi nejtur duarkryq, ne para se të filloni ky procesi i ndarjes së buxhetit sipas numrit e banoreve që kjo do të ndodhë, për ata para se të ndodhë kjo, disa herë përmes letrave të ndryshme dhe duke shkuar tek njerëzit në Ministri kemi insistuar që të merret parasysh gjendja reale në terren, dhe jo numrit e njerëzve që janë përgjigjur në regjistrim. Kur është fjala për regjistrimin e popullsisë, ajo është reflektuar edhe në Kuvend, ne tani kemi 15 anëtarë dhe sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komunat të cilët i kanë më shumë se 10.000 banorë duhet me pasur 19 anëtarë, kështu që ne kemi 4 këshilltarët më pak. Përgjigjet e lidhur me buxhetin do të sigurohen nga Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Danijel Vuksanovic: Unë do të përmend vetëm se në viti 2011 ka qenë regjistrimi, shumica e popullatës serbe nuk është përgjigjur në regjistrim, dhe kështu i humbim në çdo vit 500,000€ në projekte kapitale. Regjistrimi bëhet çdo 10 vjet, prandaj është shumë e rëndësishme që të gjithë të përgjigjemi që të mos kthehemi përsëri në këtë situatë. Rregullat që zbatohen për këtë janë të njëjta për të gjitha komunat në Kosovë dhe jo vetëm për tonën. Për fat të keq, nuk ka asnjë mënyrë për të zgjidhur këtë problem. Sa i përket arsimit, kemi marrë limit për arsimin në Qarkoren nr. 1 dhe ne nuk mund të bënim asgjë këtu. Ne do të marrim limitet përfundimtar në Qarkoren nr. 2 dhe sigurisht nuk do të jetë siç e përmenda në fillim se do të jetë 58% për paga ose 3% për subvencione. Pika më e rëndësishme gjatë gjithë këtij procesi është propozimi final i buxhetit. Është shumë e rëndësishme që qytetarët t'i përgjigjen debateve publike, në javën e parë të korrikut, për të dëgjuar se cilat janë propozimet e tyre për të planifikuar një buxhet të mirë.

Rifat Rustemi: Drejtori dha një shpjegim dhe nuk u përgjigj, ai mund të ndoll që nuk më ka kuptuar. Pse nuk është buxheti i ndarë për kokë banori? Sa i përket mjedrave, do të ishte mirë që prodhuesit të sigurohet plasmani që të ketë një treg të qëndrueshëm. Do të ishte mirë të përcaktohet një çmim i qëndrueshëm i mjedrës, pasi prodhuesit e mjedrës janë gjithmonë në pasiguri. Sa i përket arsimit, duhet parashikohet që mjetet që janë marr të mallrat dhe shërbimet të kthehen në shkollat, ato që janë marrë në vitin 2017.

Danijel Vuksanovic: E kam përmendur tashmë se buxheti është i ndarë për kokë banori. Grandi i përgjithshëm ndahet sipas numrit të banorëve, sipërfaqes së komunës, a ka komunitet pakicë dhe kjo është përafërsisht forma sipas të cilës në marrim grand. Deri në vitin 2013, kemi pasur një buxhet prej më shumë se 500,000 €, sepse është llogaritur sipas informacionit i OSBE-, dmth. që komuna ka 13,600 banorë. Bazuar në këto dhëna, kemi marrë buxhetin. Shpërndarja është sipas formulës, jo vetëm në grandin e përgjithshëm, por edhe të grandet të tjera, vetëm të shëndetësia sekondare fitojmë shumën të cilën ata e vendosin.

Predrag Grbic: A lajmërohet dikush për fjalë. Nëse nuk lajmërohet askush, vë në votim këtë pikë e rendit të ditës?

Konstatohet që me 14bbvota "për" është aprovuar kjo pika e rendit të ditës , një abstenim

4. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm

Predrag Grbic: Obligimi ynë ligjor është që një raport të paraqitet në Kuvend dhe të shqyrtohet, natyrisht, nëse dikush ka diçka për të pyetur ose diçka nuk e ka qartë. Auditorët vizitojnë komunën tonë në çdo vit, dy herë në vit, dhe pastaj analizojnë të gjithë dokumentacionin në atë periudhë që komuna ka. Ajo që është e rëndësishme është që komuna ka një bashkëpunim shumë të mirë me auditorët, në kuptim se komuna i dorëzon auditorëve të gjitha dokumentet që ata e kërkon prej nesh, kjo vlen për çdo drejtori, dhe ashtu edhe për Kuvendin. Në fund të kësaj, ne marrim një raport të tillë dhe në atë raport ka disa rekomandime, janë cekur mungesa në punën e komunës, komuna është i detyruar të punojë në eliminimin e këtyre mangësive, pra atyre rekomandimeve. Pas marrjes së raportit, ne e formojmë një grup dhe e hartojmë një plan veprimi, në të cilin janë përshkruar mënyrat me të cilat ne do të heqim ato mungesat e identifikuara nga auditorët. Në këtë rast, kemi pasur 17 rekomandime, nga të cilat 10 tashmë janë hequr, dhe 7 të tjera do të hiqen në periudhën e ardhshme. Dhe me kënaqësi mund të them që komuna e Shtërpcës është gjithmonë në krye të komunave të Kosovës.

Rifat Rustemi: Sa për këtë raport, ka disa rekomandime për të cilët nuk është ndërmarr asgjë. Në faqen 13 nën numrin 2, një buxhet të vogël për investime kapitale, pse është kështu? Ekziston edhe një memorandum ku është paguar 600 €, dhe komuna nuk ka shpjeguar për çfarë ishin ato 600 €. Do të ishte më mirë nëse ato kishin paguar nga kategoria e subvencioneve, se sa nga kategoria e investimeve kapitale. Faqja 15, ka parregullsi në Drejtorinë e Arsimit. Atu thuhet se konkursi është hapur më 20 qershor, për të plotësuar vendet e lira të punës për mësimdhënësit, për vitin shkollor 2017/18, për pranimin e mësuesve në 3 shkolla, dy shkolla fillore dhe një të mesme. Janë pranuar 8 punëtorë, nuk është përmendur se cilat shkolla janë në pyetje. Kur kemi analizuar dokumentet, kemi vërejtur se kishte disa mospërputhje me ligjin, kur janë pranuar mësimdhënësit. Në këto dokumente mungojnë dokumentet të cilët janë të parashikuara sipas ligjit, nuk theksohet për të cilët vende pune ishte konkursi. Nuk theksohet se cili numër i punëtorëve është i nevojshëm, nuk është caktuar numër i orëve për secilin vendin të punës dhe nuk ka vendim për të formuar komisionin për pranimin e mësimdhënëseve, mungojnë dëshmi për pranimin e punëtorëve. Atu kish mund të pranohet ndokush, dikush me dosje penale, duke bazuar në atë që mund të shohim. Të Drejtorisë së Shëndetësisë, të spitalit u hap konkurs për pozitën e shefit, kontrata ishte nënshkruar në vitin 2017, dhe spitali nuk punon, dhe nuk e di se çfarë do të bëjë ky punëtor. Në faqen 21, kontratë publike për ndërtimin e shkollave fillore dhe të mesme në vlerë prej 145 €, menaxheri i projektit i cili nuk kishte kualifikimin të nevojshëm për ndërtim, është i përfshirë në të gjithë sektorët. Ishte e paligjshme, sepse ai ka punuar vetëm, dhe vetit i ka dhënë para për atë, mendoj se nuk është në rregull. Faqja 25, Pasi ky raporti është paraqitur në Kuvend, Kuvendi nuk e ka diskutuar për këtë dhe nuk është përmendur zbatimi i rekomandimeve. Duhej të bëhet kjo, sepse është detyrë e Kuvendit, nëse nuk merremi na me këtë, kush tjetër do të mirë. Faqja 33, prokurimi publik, rekomandimet nuk janë marr parasysh

dhe është vazhduar më të vjetër. Menaxhimi dhe kontrolli financiar, këtu po rekomandohet përmirësimi i buxhetit, të hyrat vetanake janë shfrytëzuar për mallra dhe shërbime, ne e dimë se të ardhurat vetanake duhet të shkojnë për investime kapitale.

Predrag Grbić: Arsyeja pse ë Kuvendi vitin e kaluar nuk e ka punuar këtë pjesën e punës është se ishte vit zgjedhor, zgjedhjet ishin në nëntor dhe nuk kemi mund ta bënim atë punë.

Danijel Vuksanović: Të hyrat vetanake përbëjnë pjesën e madhe e investimeve kapitale. Në komunën tonë qytetarët tanë paguajnë taksat në dhjetor, dhe për këtë arsye ka qenë realizimi i dobët sa i përket investimeve kapitale në gjysmën e parë të vitit, në gjysmën e dytë gjithçka ka shkuar mirë. Na nuk mund ta ndikojmë në atë. Do të doja t'i përgjigjet për ato 600€ të cilët i keni përmendur, ne kemi paguar ata nga kategoria e gabuar, nga investimeve kapitale, a kish dashur nga subvencione, por nuk ka qenë e mundur që të paguhet nga subvencionet, kur ne nuk kemi subvencione.

Miloš Đukić: Më vjen keq që ne po kthehemi përsëri në kategorinë e subvencioneve, duke marrë parasysh se komuna jonë dhe zhvillimin ekonomik janë shtylla kurrizore e zhvillimit të komunës tonë, më vjen keq, por 4 vite me radhë ne nuk kemi subvencione me të cilat mund të ndihmojnë qytetarët. Sa për memorandum, ne së bashku me Komunën e Dragashit dhe Prizrenit kishim një memorandum dhe me organizatën FINC në të cilën kemi dashur të participojmë mjetet të caktuara.. Kjo pjesë e mjeteve është minimal në lidhje me grandin tq cilin na ka dhënë organizata Gjermane GIZ, qëllimi i projektit ishte që të promovojmë vlerat kulturore, natyrore dhe turistike të rajonit të Sharës. Ajo që është parashikuar me këtë projekt është hartimi i broshurave promovuese, kalendarëve, dhe krijimi i një ueb-faqe interneti në të cilën do të janë paraqitur të gjitha potencialet e rajonit Sharës. Nuk kishte asnjë mënyrë tjetër për të bashkëfinancuar projektin përveç atij kodi që ishte në atë kohë. Më vjen keq që nuk mund të punojmë më shumë në zhvillimin ekonomik, pikërisht sepse na është pamundësuar kategori e subvencioneve me një shumë më të madhe.

Danijel Vuksanovic: Ne kemi qenë të detyruar për mos me humbur atë donacion, ta paguajm nga participimi i projekteve kapitale, nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, por edhe nga kategoria e projekteve kapitale dhe subvencioneve.

Marjan Spasic: Ne gjithmonë kur e bëjmë konkurs e bazohemi në Ligjin 06/2015, 10.07.2015 të Ministrisë së Arsimit., është e vërtetë që kemi pasur disa rekomandime dhe patjetër do të përpiqemi t'i korrigjojmë këto rekomandime.

Predrag Grbic: Meqë jemi bazuar në këto përgjigje e cilën e kemi marr, mund të kuptojmë se këto nuk janë rekomandime që kufizohen me krime, përndryshe me qenë ashtu , janë të sigurt se me komunën e Shtërpeës do të merret prokurori publik.

Rifat Rustemi: Duhet të ketë një shpërndarje më të mirë të këtyre subvencioneve, sepse ka pasur rekomandime nga auditimi, se ka pasur disa parregullsi, pyetja është se ku kanë shkuar këto

fonde? Di se ka rregullore, por ju nuk jeni përmbajtur në atë. Faqja 17, komuna ka nënshkruar kontratën për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve në vlerë rreth 18,000 euro, Di që qytetarët kanë reaguar sepse nuk ishin pastruar të gjitha rrugë dhe operatori është përgjigj se nuk janë përfshimë ato rrugë në tenderin e tij. Nuk ka detaje këtu se sa kilometra janë pastruar, sa kripë është derdhur etj.

Ivica Tanasijevic: Është një kohë e gjatë që kemi këtë çështje rreth subvencioneve. Ndoshta është viti i tret ose viti i katërt me radhë që ne kërkojmë mjete për subvencione në vlerë mbi 100,000 €, dhe kjo nuk është vetëm për të subvencionuar bujqësinë, por ne kemi vënë dhe kategori të ndryshme, bursa për studentët më të mirë, ndihma për banorët më të rrezikuara, edhe në qoftë se ka një nevojë për trajtim mjekësor banoreve më të rrezikuar. Megjithatë, nga viti në vit, Ministria e Financave, në një mënyrë nuk ka mirëkuptim për nevojat tona, si me qenë që nga viti në vit e kopjojnë këto subvencione, pa dëgjuar të vërtetë nevojat tona, legjitime. Të gjithë kërkojmë argumente, çdo cent që kemi kërkuar nga Ministri i Financave është i justifikuar dhe për këtë ka dokumentacion të vlefshëm. Këtë vit kemi pasur një takim me zëvendësministrin e Financave dhe me drejtorët, ku ne kemi shpjeguar kërkesat tona nga sivjet, kështu që ne shpresojmë se në këtë vit do të në dëgjojnë. Ajo që ka ndodh në lidhje me subvencionet në vitet e mëparshme, ne pothuajse nuk ka shpenzuar as fondet për subvencione, subvencione janë bartur në këtë vit, për shkak të udhëzimeve administrative sipas të cilit duhet të shpallët një konkurs, dhe duhet të formohen tri komisione të ndryshme për të gjitha këto mjete të ndara. Nuk e dimë se ku do të ndajmë së parë këto mjete, nevojat dhe kërkesat e qytetarëve janë të mëdha dhe mjetet janë minimale dhe qesharake kur bëhet fjalë për funksionimin e një institucioni të tillë si që është komuna. Ajo që kërkuam në këtë vit, është se kërkesa jonë për subvencione për këtë vit merret seriozisht dhe shqyrtohet dhe se këto mjete në japin. Ne do të punojmë sipas ligjit dhe ashtu si ajo duhet të bëhet, do të formohet sipas ligjit që ju keni miratuar dhe me komisionet të ndryshme, të cilat do të merren me subvencionet e ndryshme. Keni drejt, nuk është projekti i vetëm ku ne kishim nevojë që të bëjmë do akrobacionet për të nxër disa mjete të mëdha për këto 600 €, Komuna e Shtërpçës ka marrë 10 herë më shumë mjete, gjithashtu kemi financuar projekte të ndryshme ku nuk kemi guxuar të humbim subvencionet. Kishte pasur dhe rekomandime të tjera për një projekt serioz që po punojmë se bashku me një organizatë ndërkombëtare ku ne kemi pasur nevojë që paraprakisht të rezervojmë mjete për të fituar atë projekt. Ne me vetëdije kemi hyrë diku, duke besuar që ajo është e mirë për komunën tonë dhe për qytetarët tanë dhe natyrisht ne e dinim se do të gjendet në raportin e auditimit. Në të ardhmen, ne do të përpiqemi që nëse kërkesat tonë kanë sukses të realizojmë të gjitha nevojat të cilët e kanë qytetarët tanë.

5. Të ndryshme.

Predrag Grbic: Në seancën e fundit, g. Rustemi keni bërë një kritikë në lidhje me faqen tonë të internetit. Nuk e di nëse keni pasur mundësi ta shikoni tani, është bërë fantastik dhe ne jemi komunë e vetme që e ka këtë faqe në të dy gjuhët zyrtare, ndryshe nga komunat tjera që nuk e kanë atë. Dhe ne kemi një faqe FB që gjithashtu informon qytetarët në të dy gjuhët.

Rifat Rustemi: Është e vërtetë se ka përmirësime, e ndjek rregullisht. Nuk e gjeta ftesën dhe agjendën për mbajtjen e kësaj seancës, ndoshta është, por nuk e gjeta. Kam vënë re një vend promovimit për komunën e Shtërpçës në faqen e internetit, megjithatë, nuk mund të shihet Firaja, as Brod, as xhamiat.

Ivica Tanasijevic: Ka disa spoteve promovuese, megjithatë, shumica e tyre kanë bërë persona privatë kështu që ne nuk kemi mundur të ndikojmë në atë. Disa vjet më parë, kemi bërë një promo-spoti në bashkëpunim me komunën, ne do të përpiqemi ta gjejmë dhe ta vendosim në ueb-faqen. Atu mund të shihni të gjithë trashëgiminë kulturore të komunës tonë dhe të gjitha objektet fetare. Mos me mbani për fjalën time, por mendoj që mund të gjej këtë promo-spotin me zyrtarin tonë të IT-së dhe nëse e gjejmë, ai me siguri do të jetë në ueb-faqen tonë të.

Rifat Rustemi: Kam një propozim për Drejtorin e Shërbimeve Publike. A ka dal dikush nga zyrtarëve në terren pas shiut që ka rënë këto ditë për të parë dëmet e shkaktuara nga këto reshje? Dhe çfarë keni bërë në lidhje me njoftimin për përkeqësimet e kohës që po parashihihen? Ka shumë rrugë që janë dëmtuar, në Kostanjev, Brod, ndoshta ka edhe në vende të tjera, po ju tregoj vetëm për vendet që unë e pashë. A mund të sanohen ato, sepse nuk mund të shkohet me veturë në disa fshatra. Ju gjithashtu mund të shihni se makina nuk mund të kalojnë, kto vendet janë në një lartësi më të lartë.

Sinisa Buduric: Ne jemi në terren çdo ditë, duke monitoruar situatën. Për shkak të këtyre reshjeve, të gjithë zjarrfikësit janë në dispozicion, nun-stop janë kujdestar, kur ka nevojë që ata të shkojnë në terren. Ka fond riparues për sanimin, në rast të dëmtimit për shkak të reshjeve, vetëm duhet të lajmërohet vendndodhja ku ka ndodh problemi dhe ne menjëherë do të dalim në terren.

Rifat Rustemi: Do të përmendja një shqetësim që është në mesin e qytetarëve e fshatit Brod, atje ka qenë një ujësjellës, pas punimeve në hidrocentralin, ai ishte i zhdukur. Pran kishës, ujësjellësin e kanë humbi në fushat ku janë mbjell mjedra. Një kompani private u përpoq të gjejë një zgjidhje të përkohshme, do të ishte një ide e mirë për ne që të përpiqemi të gjejmë një zgjidhje të qëndrueshme.

Predrag Grbic: Njerëzit që drejtojnë komunën nuk e kanë dëgjuar për këtë problem, jam i sigurt se ata do të marrin të gjitha masat e mundshme për të zgjidhur këtë problem. A lajmërohet dikush tjetër për fjalë? Meqë askush nuk lajmërohet, seanca e sotme ka mbaruar.

Procesmbajtësi
Staja Markovic



Kryesuesi i Kuvendit
Predrag Grbic